

# Punonjësit në hije, Ekonomia e Fshehur dhe Puna e Padeklaruar në Maqedoni Shqipëri dhe Kosovë

Raporti i politikave Nr.38, Janar 2017

## 1. Hyrje

Zakonisht fjalë si “në hije”, “e fshehtë”, “informale”, “e padeklaruar”, “gri” dhe “e pavëzhguar” janë përdorur në vend të fjalës “e fshehtë”, për të përshkruar pashmangshmërisht të njëjtin fenomen por në perspektiva të ndryshme. Për ta qartësuar, gjatë tekstit, termi ekonomi “e fshehur” do të përdoret për të

*Një punëtor fabrike ka një punë të dytë gjatë natës si një hidraulik i palicencuar për familje të vogla, një elektrikist instalon një nxehtësi uji të ri dhe paguhet në cash, kështu ai shmang deklarimin e atyre të ardhurave tek autoritetet fiskale; një profesionist IT, përveç kontratës së pagesës minimale, merr një pagesë shtesë “me zarf”; një nënë beqare e dy fëmijëve, në përfitim të punëdhënësit, pranon të punojë mbi bazën e një kontrate shërbimi të përkohshme, në mënyrë që të mos e humbasë punën e saj dhe të ketë nivelin bazik të jetesës. Këto janë të gjitha shembuj ose variacione të punës të padeklaruar.*

përshkruar aktivitetet dhe praktikën ekonomike që janë ligjore (jo kriminale) për sa i përket natyrës së tyre, por që mbeten të padeklaruar tek autoritetet, ndryshe nga ekonomia “e zezë” që referohet për aktivitete dhe praktika joligjore

## Pikat kryesore

- Niveli i lartë i papunësisë (24% në Maqedoni, 15.9% në Shqipëri, dhe 32.9% në Kosovë, sipas të dhënave të tremujorit të dytë 2016), është një nga treguesit më të rëndësishëm që ndikon në rritjen e praktikave dhe aktivitetit të ekonomisë së fshehur.
- Fokusi kryesor për të luftuar punën e padeklaruar, ashtu si në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Lindore, është në kufizimin e shkeljeve të Ligjit të Punës. Politikat, që kanë dominuar në këto shtete, kanë qenë masat me qëllim përmirësimit e zbulimit të këtyre shkeljeve si dhe zbatimi i ndërhyrjeve të rrepta.
- Pagat e fshehura vazhdojnë të jenë shqetësimi kryesor, me të ardhurat nga punësimi, të cilat janë pjesërisht ose totalisht të padeklaruar për pothuajse gjysmën (44%) e të punësuarve në Maqedoni (në rritje nga 40% që ishte në vitin 2014), 36% në Shqipëri dhe 37% e të punësuarve në Kosovë.
- Arsimi ndikon në ekonominë informale. Vetëm 56.8% e të punësuarve me arsim të ulët në Maqedoni, 20.6% në Shqipëri dhe asnjë në Kosovë, kanë arritur të kenë një kontratë të shkruar për punën e tyre primare, në krahasim me më shumë se 80% e të punësuarve me arsim të lartë.

Kostot	Përfitimet
<p><b>Për bizneset e ligjshme:</b>  <b>Shkakton konkurrencë të padrejtë për bizneset e ligjshme.</b>  <b>Inkurajon “efektin zinxhir” pasi bizneset e ligjshme do të shmangen edhe ato, në mënyrë që të konkurrojnë me bizneset në hije.</b></p>	<p>Instrument nxitës për bizneset e reja.</p>
<p><b>Për bizneset e padeklaruar:</b>  <b>Pengon rritjen pasi është e pamundur për të patur akses në kapital, siguruar mbështetje biznesi apo të reklamojë haptazi.</b>  <b>Mund të vihet nën presion për marrëdhënie shfrytëzuese me biznese të ligjshëm.</b></p>	<p>Mund të testojnë leverdishmërinë e ndërmarrjes së tyre.</p>
<p><b>Për punëtorët e padeklaruar:</b>  Mungesë akses në marrjen e kredisë dhe shërbimeve financiare, pjesërisht për shkak të historisë së kreditimit të limituar.  S’ka aplikueshmëri të të drejtave të punës (p.sh. pagesë minimale, pagesë gjatë problemeve shëndetësore, të drejtat kur ka shkurtim të vendeve të punës).  Barriera më të mëdha hyrjeje në tregun formal, për shkak të paaftësisë për të ofruar histori punësimi.  Nuk mund të sjellë të drejta për pension shtetëror, apo përfitime prej kontributeve të tjera, apo të ketë akses në skemat e tjera të pensioneve.  Mungesë akses për standardet e sigurisë dhe shëndetësisë, si dhe pamundësia për të negociuar dhe për të ngritur zërin kur shkelen të drejtat.</p>	<p>Burim të ardhurash.  Redukton barrierat për t’u futur në punë pasi shumica e punës së padeklaruar lidhet me marrëdhëniet e ngushta shoqërore.</p>
<p><b>Për klientët:</b>  Mungesë e së drejtës ligjore nëse është bërë një punë e dobët, mos-mbulim siguracioni, mungesë garancie në lidhje me punën e kryer, si dhe mungesë garancie, që janë ndjekur rregullat e sigurisë dhe shëndetit.</p>	<p>Produkte dhe shërbime më të përballueshme për konsumatorët.</p>
<p><b>Për qeveritë:</b>  Shkakton humbje të ardhurash për shtetin në kuadër të mospagimit të tatimit mbi të ardhurat personale, kontributeve të sigurimit dhe TVSH-së.  Redukton të ardhurat në qarkullim për qeveritë që duan të promovojnë integrimin dhe lëvizshmërinë shoqërore.  Mungesë e kontrollit të autoriteteve lidhur me cilësinë e punëve dhe shërbimeve.</p>	<p>Vendos kufi për regjimet me barrë të rëndë rregullative dhe taksash</p>

(kriminale). Megjithëse, të gjitha këto terma, që po i përmbledhim në termin “e fshehur”,

nënkuptojnë një konotacion negativ, duhet të theksohet se në terma afatshkurta dhe afatmesme ekonomia e fshehur mund t’i ndihmojë shoqëritë dhe banorët e tyre të rimëkëmben nga kriza ekonomike të rënda apo nga tranzicioni, për shembull nga ekonomia socialiste te ekonomia e bazuar në tregun e lirë. Sidoqoftë, në terma afatmesme dhe afatgjatë ajo vë në rrezik pagesat sociale të punëtorëve, rrit pabarazinë, konkurrencën e padrejtë, dhe disbalancat ekonomike.

Ka diferenca të mëdha mes vendeve dhe rajoneve në lidhje me madhësinë, fushën dhe sektorët kryesorë të funksionimit të ekonomisë së padeklaruar në Evropë, e cila, sipas shifrave të gjetura nga BE-ja (Eurofound) luhatet mesatarisht në 18% të PBB-së në Bashkimin Europian, duke variuar nga më pak se 8% e PBB-së (Austri) në më shumë se 30% e PBB-së (Bullgari). Puna e padeklaruar është më e përhapur në industrinë e ndërtimit, por është gjithashtu e përhapur në shërbimet familjare, sigurinë private,

pastrimin industrial, agrikulturë, dhe në industrinë e mikpritjes dhe catering-ut.<sup>1</sup>

Pashmangshmërisht, politika dhe mjedisi ekonomik i vendit në fjalë, krijon mekanizma të posaçme

---

*“Përmirësimi i performancës qeveritare për të arritur objektivat sociale nënkupton kthesën nga një ekonomi e shmangies së taksave pa infrastrukturë dhe me pagesa sociale të keq-shënjestuara, në një ekonomi formale të pagimit të taksave, me pagesa sociale të vogla, por eficiente. Sidoqoftë, shumë prej këtyre reformave nuk ka gjasa të kenë sukses pa një ulje të korrupsionit dhe ineficiencës burokratike” (Alesina 1999) p.229*

---

Source: Bank of Albania, “Albania’s Informal Economy: An Impediment to Economic Development” (2001), accessed 07.10.2016

[https://www.bankofalbania.org/web/pub/JanPeterOlters\\_240\\_1.pdf](https://www.bankofalbania.org/web/pub/JanPeterOlters_240_1.pdf)

nxitësish, të cilat sjellin kosto dhe përfitime për t’u përfshirë në ekonominë e fshehur (shiko kostot dhe përfitimet tipike në Tabelën 1). Ky dokument politikash krahasuese ofron një panoramë të ekonomisë së fshehur në përgjithësi si dhe të punës së padeklaruar dhe evazionit fiskal në veçanti, në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë, përfshirë shkaqet dhe pasojat kryesore. Për më tepër, ai ofron një këndvështrim makroekonomik të faktorëve kryesorë, që vlerësohet se nxisin ekonominë e fshehur, dhe në të njëjtën kohë tenton të ofrojë arsytet, përmes përpunimit të të dhënave të pyetësorëve, të cilat japin perceptimet, që lidhen me këtë çështje kaq të rëndësishme. Për më tepër, dokumenti ofron sugjerime se si mund të adresohet ky fenomen, si janë këto tre vende në raport me njëri-tjetrin dhe çfarë masash janë marrë dhe duhet të merren për ta luftuar atë.

## 2. Faktorët makro-ekonomikë dhe Tregu i Punës

Përmbajtja e kodit të punës, niveli i papunësisë (përfshirë nënkategoritë e tij), dhe sistemi kombëtar i taksimit, përfaqësojnë thelbin e një rrjeti faktorësh kompleksë, që përcaktojnë hapësirën dhe strukturën e punës së padeklaruar. Të luftosh ekonominë e fshehur sidoqoftë është një thikë me dy tehe. Në njërin anë, nëse qeveria dhe institucionet e saj rregullative, kanë kontroll të dobët, duke e toleruar ekonominë informale, kjo çon në humbje të rëndësishme të të ardhurave potenciale dhe përmirësimit cilësor dhe sasior të shërbimeve dhe të mirave publike.

Në anën tjetër, nëse qeveria ngutet për të përdorur nisma negative (masa ndëshkimore, zbatim më të mirë të ligjit), që përdoren për të shtrënguar fuqishëm ekonominë e fshehur, kjo mund të krijojë efekte reale problematike anësore: reduktim i të ardhurave të disponueshme dhe rritje të kostove të punës, që do të përktheheshin në rënie konsumi, rënie eksporti, dhe rënie të PBB-së. Çfarë mund të vijë më vonë është një rënie në punësimin formal, në raport me punësimin e fshehur, pasi kompanitë luftojnë për rritjen e efikasitetit të çmimeve dhe produktivitetit. Kështu, monitorimi dhe menaxhimi i ekonomisë së fshehur është një akt i brishtë balancimi midis nevojës për zbatimin e masave të tanishme dhe të ardhshme dhe plotësimin e nevojave aktuale të ekonomisë në përgjithësi, në mënyrë që shoqëritë të lulëzojnë dhe të krijojnë perspektiva afatgjata.

*Niveli i Lartë i Papunësisë, Papunësia Afatgjatë dhe papunësia e lartë tek të rinjtë nxisin Informalitetin në Maqedoni.*

---

<sup>1</sup>European Parliament News (02.02.2016) “European platform to tackle undeclared work.” Accessed 19.07.2016 <<http://www.europarl.europa.eu/news/en/news-room/20160129IPR11935/European-platform-to-tackleundeclared-work>>

**Indikatori më i rëndësishëm dhe përkeqësues në lidhje me ekonominë e fshehur në Maqedoni është niveli i luhatur i papunësisë prej 24% (Q2 2016).** Niveli ekstremisht i lartë i papunësisë afatgjatë (81.6% e të papunëve në vitin 2015) sugjeron se një përqindje e madhe e të papunëve do të duhet të angazhohen në disa aktivitete të fshehura, në mënyrë që të sigurojnë një nivel elementar të jetesës. Këta punëtorë të padeklaruar janë pjesa më e mundshme për t'u përfshirë në industri dhe shërbime ku transaksionet në cash kryhen rregullisht, duke përfshirë një varietet punësh artizanale, tregti, etj. Pesha e madhe e këtij sektori jetësor të ekonomisë së fshehur e bën edhe më të vështirë për qeverinë të shënjestrojë forma të tjera të punësimit të padeklaruar, pa cenuar të drejtat e njeriut të grupit të parë. Shumë studime kanë konfirmuar nivelet kokëforta të punës të padeklaruar në Maqedoni, e llogaritur të jetë 34.9% e PBB-së<sup>2</sup>.

### **Mungesa e zbatimit të rregullave dhe korrupsioni i lidhur me to kanë një efekt edhe më të madh në ekonominë informale në Shqipëri.**

Papunësia në Shqipëri nuk është aq e rëndë sa në dy vendet e tjera por përsëri është më lart se mesatarja e BE-së dhe qëndron te 15.9% (tremujori i dytë 2016), dhe si e tillë patjetër mund të jetë një burim informaliteti. Informacioni për madhësinë e ekonomisë së padeklaruar është vërtet i limituar. Sidoqoftë, duke përdorur metodologji të ndryshme matje, llogaritjet variojnë nga 30 – 45% të PBB-së totale të Shqipërisë,<sup>3</sup> e cila është në linjë me vlerësimin e Schneider (2002)<sup>4</sup> dhe Institutin Shqiptar të Statistikave (INSTAT), i cili vlerëson ekonominë

<sup>2</sup>Williams, C.C., Baric, M. and Renooy, P. (2013) *Tackling Undeclared Work in Macedonia*. Dublin: Eurofound.

<sup>3</sup>ETF (2010), "Albania Country Information Note 2010 - 2012", ETF, Turin, <<http://www.etf.europa.eu>>

<sup>4</sup>Schneider, Friedrich, 2002, "The Value Added of Underground Activities: Size and Measurement of the Shadow Economies of 110 Countries all over the World," Johannes Kepler Universitat Linz, Mimeo. (First version, June 2002).

## **Metodologjia e Pyetësorit**

(pyetësori i popullsisë 2016, CRPM/IDM/D4D)

*Të dhënat e paraqitura më poshtë janë të bazuara në tre pyetësorë të popullsisë me metodologji identike, me përfaqësim rajonal dhe demografik të kryera në Maj dhe Qershor 2016 në Maqedoni (1097 pjesëmarrës), Shqipëri (1102 pjesëmarrës) dhe Kosovë (1100 pjesëmarrës). Për më shumë, janë përfshirë për një shikim krahasues të ndryshimeve për një periudhë dy-vjeçare edhe rezultatet e pyetësorit të së njëjtës popullsi, e organizuar në Maqedoni në tetor 2016. Pyetësorët, me intervista ballë për ballë të realizuara në çdo shtëpi, janë një nga metodat e drejtpërdrejta për të vlerësuar aktivitetet e fshehura ekonomike dhe ofrojnë informacion të ndryshëm dhe kualitativ në krahasim me qasjet indirekte të përdorura në mënyrë tradicionale, të cilat zakonisht paraqesin ekonominë e fshehur në % të PBB. Sipas rezultateve të pyetësorit, angazhimet primare dhe dytësore mund të shihen në Tabelën 2.*

*Tabela 2 – përqindja e të anketuarve, që kanë raportuar të kenë një punë primare dhe (lloje të ndryshme) të punësimit sekondar. Burimi: Vrojtimi i popullsisë i CRPM/IDM/D4D, 2016*

	MK	AL	KS
<b>Punësim primar</b>	50.9	54.5	50.7
<b>Punësim dytësor i paguar</b>	10.5	23.8	3.2
<b>Aktivitete të lidhura me prodhimin shtëpiak</b>	10.3	24.6	14.1
<b>Shërbime të paguara të miqtë/familjet</b>	1.6	3.8	25.8
<b>Shërbime të papaguara</b>	5.2	7	25.1

informale si 1/3 e PBB-së të vitit 2000<sup>5</sup>. Sipas ILO afërsisht 27% e punëtorëve jo në sektorin bujqësor

<sup>5</sup>According to Schneider's (2002) estimation method, the size of Albania's informal sector is comparable to those in Lithuania (30.3 percent), Croatia (33.4 percent), Bosnia and Herzegovina (34.1 percent), Romania (34.4 percent), and Bulgaria (36.9 percent).

janë punësuar në ekonominë informale, dhe pjesa më e madhe e tyre janë në sektorin e ndërtimit<sup>6</sup>.

### *Norma e lartë e papunësisë dëmton rritjen ekonomike në Kosovë.*

Kosova është një vend me të ardhura të mesme dhe të ulëta, ajo ka dëshmuar një rritje ekonomike modeste që prej fundit të luftës në 1998-9. Kosova ka afërsisht 1.8 milion banorë, dhe një diasporë të madhe që banon në vendet e Evropës Perëndimore. Sipas Fondit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (FZHKB), një në 4 kosovarë jeton jashtë dhe remitancat e tyre përbëjnë një të pestat e PBB-së<sup>7</sup>. Për shkak të këtij efekti, ekonomia është shumë e varur nga pagesat e remitancave nga jashtë dhe fluksin e qëndrueshëm të mbështetjes nëpërmjet donacioneve<sup>8</sup>.

Kosova është mbrapa në termat e zhvillimit ekonomik në krahasim me vendet fqinjë dhe vendeve evropiane. Ajo kishte Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) për banor më të ulët, me 2,900 euro në vitin 2013<sup>9</sup>. E pozicionuar në juglindje të Evropës, Kosova ka nivelin më të lartë të varfërisë, me më shumë se 30% të popullsisë që jeton poshtë nivelit minimal të jetesës, dhe me nivelin e papunësisë më të lartë, prej 30.9%<sup>10</sup>. Sipas statistikave zyrtare të punës, papunësia ka qëndruar mbi 30% gjatë 4-vjeçarit të fundit. Vlerësimet e Bankës Botërore tregojnë se papunësia e rinisë është më e lartë, ajo i kalon 55%.<sup>11</sup> Duke pasur një cilësi të

dobët edukimi dhe mundësi të limituara punësimi, bëhet më e vështirë që të rinjtë të hyjnë në tregun e punës. Si pasojë, shumë prej tyre përfshihen në punë, që kërkojnë kualifikim të ulët ose në ekonominë informale. Për shumë ekonomistë, sektori informal është përçarësi i ekonomisë kombëtare dhe një pengesë zhvillimi. Sipas interpretimit të Institutit Riinvest, të të dhënave të Bankës Botërore për Kosovën, papunësia aty i kalon 30%, tregu gri arrin 40% të PBB-së të vendit<sup>12</sup>, dhe pabarazia arrin në 26.7 (GINI Index 2013).<sup>13</sup> Si pasojë, buxheti i shtetit humbet më shumë se 300 milionë euro në vit (duke llogaritur vetëm humbjet potenciale të TVSH), të cilat mund të përdreshin për të përmirësuar cilësinë dhe sasinë e të mirave dhe shërbimeve publike. Midis shumë të tjerash, kjo çon në humbjen e të ardhurave dhe redukon disponueshmërinë e përfitimeve dhe të drejtave të punësimi.<sup>14</sup>

Shumë autorë (Loayza 1997, Johnson, Kaufmann, dhe Shleifer, 1997) shprehen se ekonomitë me sektorë të lartë informalë si Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova, kanë prirje që të ngelin në atë rrethin vicioz të të mirave publike me cilësi të ulët, dhe një nivel të lartë evazioni fiskal. Autorët kanë analizuar një numër të madh të ekonomive në tranzicion të Evropës Lindore dhe ish Bashkimit Sovjetik, dhe kanë zbuluar se bizneset reagojnë ndaj nivelit të lartë të politizimit të aktiviteteve të sektorit privat, me tendencën për t'u larguar nga sektori formal,<sup>15</sup> i cili lë

<sup>6</sup>International Labor Organization (ILO), "Albania Decent Work Country Programme Document 2008–2010" (2008), accessed 07.10.2016,

[www.ilo.org/public/english/region/eurpro/.../dwcp\\_albania.pdf](http://www.ilo.org/public/english/region/eurpro/.../dwcp_albania.pdf)

<sup>7</sup>UNDP. Kosovo Human Development 2014. September 2014, p.v.

<sup>8</sup>World Bank. Republic of Kosovo: Kosovo Public Finance Review. June 2014, p. 1.

<sup>9</sup>Ibid, p. ii.

<sup>10</sup>Ibid, p. 1.

<sup>11</sup>World Bank, The World Bank Group in Kosovo, Country Snapshot (2015). Accessed 07.10.2016  
<<http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>>

<sup>12</sup>Riinvest Institute, "To Pay or Not to Pay - A business perspective of Informality in Kosovo" (2013).

<[http://riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/BUSINESS\\_INFORMALITY\\_5mm\\_bleed\\_no\\_inside\\_ENG\\_FINALV\\_31394\\_38573.pdf](http://riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/BUSINESS_INFORMALITY_5mm_bleed_no_inside_ENG_FINALV_31394_38573.pdf)>

<sup>13</sup>The World Bank GINI Index data (2006-2013), Accessed 15.09.2016

<<http://data.worldbank.org/indicator/SI.POV.GINI?locations=XK>>

<sup>14</sup>Colin C. Williams, "The undeclared sector, selfemployment and public policy", International Journal of Entrepreneurial Behavior & Research, Vol. 11 Iss: 4, pp.244 – 257, accessed 28.09.2016  
<<http://www.emeraldinsight.com/doi/pdfplus/10.1108/13552550510603289>>


<sup>15</sup>Johnson, Simon, Daniel Kaufmann, and Andrei Shleifer, (1997), "The Unofficial Economy in Transition" Brookings Papers on Economic Activity, No. 2, pp. 159-221.

të kuptohet se pa reforma të sinkronizuara, që forcojnë institucionet mbështetëse të tregut, stabilizimi makroekonomik nuk është i mjaftueshëm për të mirëmbajtur rritjen e lartë ekonomike.


Friedman (2000) e zgjeron edhe më tej gjetjen e tyre duke pohuar se një aplikim selektiv i zbatimit të ligjit, dhe korrupsionit, që prodhon inefficienca e sistemit, duket se ka një efekt më të rëndësishëm<sup>16</sup>, si p.sh. barrë më e lartë taksash shtesë, të cilat janë cituar shpesh si arsye kryesore për nivelin e lartë të sektorit informal.

Grafiku 1 – Renditjet e Shqipërisë dhe Maqedonisë në Indeks të Konkurrueshmërisë Globale (2016-2017). Burimi: World Economic Forum <http://www3.weforum.org/docs/gcr/2015-2016/Global Competitiveness Report 2015-2016.pdf>

Edition	2012-13	2013-14	2014-15	2015-16	2016-17
Rank	80 / 144	73 / 148	63 / 144	60 / 140	68 / 138
Score	4.0	4.1	4.3	4.3	4.2




Edition	2012-13	2013-14	2014-15	2015-16	2016-17
Rank	89 / 144	95 / 148	97 / 144	93 / 140	80 / 138
Score	3.9	3.8	3.8	3.9	4.1



Indeksi i konkurrueshmërisë globale vjetore i Forumit Ekonomik Botëror, bazuar në 12 shtyllat/faktorët (Shih 1) hedh pak dritë mbi horizontin e politikave që pashmangshmërisht kanë ndikim në ekonominë informale, në kontekstin rajonal dhe të përkohshëm. Maqedonia ka përjetuar përqesimin të këtyre indikatorëve, të cilët sollën rënien e saj me 8 pozicione (68) gjatë periudhës 2016-2017. Hapësira më e madhe për përmirësim mbetet te shtyllat: infrastrukturë, madhësia e tregut, inovacioni dhe gatishmëria teknologjike. Ndryshe nga vitet e tjera, kryesisht për shkak të krizave të zgatuara politike, **destabiliteti i politikave përbën tani faktorin më problematik për të bërë biznes në Maqedoni**, i ndjekur nga aksesit për financim, kualifikimi jo i duhur i fuqisë punëtore, dhe etika e dobët e punës në fuqinë punëtore kombëtare.

Shqipëria e përmirësoi vendin e saj me 13 pozicione (80) dhe ka të njëjtën hapësirë përmirësimi si Maqedonia - infrastrukturë, madhësia e tregut, inovacioni dhe gatishmëria teknologjike. Sidoqoftë **faktorët më të mëdhenj pengues për të bërë biznes në Shqipëri fillojnë me korrupsionin në krye, i ndjekur nga niveli i taksave, kualifikimi jo i duhur i fuqisë punëtore, aksesit për financim, dhe përsëri destabiliteti politik**. Këto renditje vit mbas viti, ofrojnë një panoramë të përgjithshme të elementëve aktualë dhe potencialë të punës së padeklaruar dhe evazionit fiskal, dhe i ndihmojnë hulumtuesit të shënjestrojnë burimet dhe mënyrën e shfaqjes së aktiviteteve të fshehura ekonomike.

### 3. Puna e padeklaruar – Rezultatet e sondazhit



Grafiku 2 –A keni një kontratë të shkruar për punën tuaj primare (Q.3)? Burimi: Vrojtimi i CRPM/IDM/D4D 2016 (popullsia).

Pothuajse gjysma e punëtorëve në Maqedoni kanë një pjesë të rrogës së tyre të fshehur, dhe çdo një në pesë punëtorë në Kosovë dhe Shqipëri punon pa një kontratë të nënshkruar punësimi. Kontratat e nënshkruara të punësimit përfaqësojnë një element të rëndësishëm me anë të të cilit punëtorët marrin mbrojtje ligjore nën ligjin e punës dhe sigurojnë pagesën për kontributet shëndetësore dhe shoqërore. Prandaj, mungesa e një kontrate të nënshkruar përbën një burim pasigurie për punëtorët dhe një tentativë për aktivitete të fshehura ekonomike, si p.sh., punë e padeklaruar, e shoqëruar me konkurrencë të padrejtë midis punëdhënësve, e cila zakonisht sjell aktivitete të fshehura ekonomike. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ka deklaruar se “Mesatarisht, krahasuar me punëtorët formalë, punëtorët informalë kanë të ardhura më të ulëta, dhe përballen me rreziqe më të larta, kanë më pak gjasa të përfitojnë mundësi ekonomike dhe mbrojtjen ligjore, si dhe janë më pak të aftë për të ushtruar të drejtat ekonomike dhe të kenë zë kolektiv.”<sup>17</sup> Grafiku 2 tregon se **9% e të gjithë punëtorëve në Maqedoni punojnë pa kontratë (është rritur nga 7% që ishte në vitin 2014)**, madje nuk u paguhen as kontributet e sigurimeve shoqërore.


<sup>17</sup> ILO (2013) *Labour inspections and undeclared work in the eu*. Accessed on 25.08.2016  
<[http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed\\_dialogue/---lab\\_admin/documents/publication/wcms\\_220021.pdf](http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_dialogue/---lab_admin/documents/publication/wcms_220021.pdf)>

Përqindja e këtyre punëtorëve në Shqipëri dhe Kosovë është dyfish dhe përbën respektivisht 17% dhe 21% të të gjithë punëtorëve. Duke përdorur vlerat absolute për përgjigjet ‘pa kontratë’ nga Grafiku 2 dhe duke i përpunuar ato me të dhënat nga Grafiku 4 më poshtë, rezultojnë se përqindja e pagesave të fshehura përbën shqetësimin thelbësor, me të ardhurat nga punësimi që janë pjesërisht ose totalisht të padeklaruara për rreth 1/2 e punëtorëve në Maqedoni (44%, nga 40% që ishte në vitin 2014), ndërsa në Shqipëri dhe Kosovë përkatësisht 36% dhe 37%<sup>18</sup>.

*Punësimi shtesë/dytësor, mbizotëron mungesa e kontratave të shkruara*

**Në lidhje me profesionin shtesë/dytësor**, përfshirë vetëpunësimin, situata është edhe më shqetësuese, me një shumicë dërmuese të profesionit dytësor në Maqedoni dhe Kosovë (rreth 90%) që operon pa kontratë të shkruar. Në rastet kur kontratat ekzistojnë, ato janë zakonisht me afat të paracaktuar, marrëveshje autorësie, apo ndonjë lloj tjetër shërbim kontrate të përkohshme. Shqipëria duket se është më mirë se dy vendet e tjera me një peshë prej 55.6% të punëtorëve në profesionin dytësor që kanë një kontratë të shkruar (përfshirë të vetë-punësuarit).

<sup>18</sup> Përqindjet e ndryshme për kategorinë “Pa Kontratë” në Grafikon 4 kundrejt Grafikut 2 mund të vijë si rrjedhojë e përdorimit të vlerave absolute nga Grafiku 2 ose pyetja Q.3 nga vrojtimi në llogaritjen e përqindjes të vlerave në Grafikon 4 ose pyetjes Q.7A nga vrojtimi. Të shtojë thjesht përqindjet e “Pa Kontratë” nga Grafiku 2 në Grafikon 4 nuk do të ishte korrekte nga ana metodologjike.




Grafiku 3 – “Kush i paguan kontributet tuaja të sigurimeve shoqërore?(Q.13)” Vrojtimi i CRPM/IDM/D4D 2016 (popullsia).

Në të njëjtën linjë, kontributet e sigurimeve shoqërore nuk paguhen në më shumë se 80% të rasteve në Maqedoni dhe Kosovë, dhe 39% në Shqipëri. Për më tepër, sigurimet shëndetësore për punësimin dytësor nuk paguhen ndaj 77.3% të punëtorëve në Maqedoni dhe 100% në Kosovë.

### ***Punësimi shtesë/dytësor i karakterizuar nga nivele ekstremisht të ulëta të pagesave të sigurimeve shoqërore, kontributeve shëndetësore dhe tatimi i të ardhurave personale.***

Shqipëria shfaqet sërish më mirë përse i përket sistemeve të ndryshme të pagesës të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, ku vetëm 1/3 e punëtorëve të punësimit dytësor nuk e paguajnë atë. Rreth 60% e të anketuarve në Maqedoni dhe Shqipëri, dhe pothuajse 90% në Kosovë nuk e raportojnë dhe/ose paguajnë tatim të të ardhurave personale për aktivitetet e tyre shtesë.




Grafiku 4 – Cili është niveli i pagës, mbi të cilin paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi (Q.7A)? Vrojtimi i CRPM/IDM/D4D 2016 (popullsia).

Të pasurit ose mos të pasurit e kontratës nuk e tregojnë domosdoshmërisht spektrumit e plotë të punësimit të fshehur. Siç paraqitet dhe në Grafikon 4, diferenca midis pagave të shkruara në kontratë dhe shumës aktuale të paguar (me pagat zarf ose llojet e tjera të kontratave të shërbimit të përkohshëm), gjithashtu ofron një pasqyrë të mirë që inspektorët dhe ministritë e punës mund të përdorin, që në mënyrë të përshtatshme të orientojnë masat e tyre, që kanë për qëllim luftën ndaj punës së padeklaruar. Siç tregon grafiku i parë, **më shumë se 1/3 (37.3%) e të punësuarve në Maqedoni, ¼ (22.7%) në Shqipëri dhe 1/5 (20.5%) në Kosovë kanë kontributin e tyre të sigurimeve shoqërore të paguara nga punëdhënësit për pagat e kontraktuara, që janë më të ulëta, se paga aktuale që ata marrin.** Situata në Maqedoni është pak më keq se në vitin 2014. Ndërsa në Maqedoni dhe Shqipëri rreth gjysma e të punësuarve kanë pagat e paguara sa shuma e përcaktuar në kontratat e tyre, punonjësit e Kosovës renditen më mirë në këtë kategori me 66.1% që zbatojnë këtë praktikë të mirë. Dallimi, përsëri, mund të llogaritet nga fakti se punëdhënësit e Kosovës nuk janë të detyruar me ligj të paguajnë për sigurimin shëndetësor të punonjësve të tyre.



### Perceptimet negative mbi sigurimin shoqëror dhe shëndetësor mund të sjellin nxitje për informalitetin.


Duke vlerësuar nivelin e pranimit me deklarata të ndryshme që lidhen me ekonominë e fshehur, atëherë bëhet e qartë se niveli aktual i kënaqësisë me pagën e tyre, për shumë punëtorë, është shumë më i rëndësishëm se siguria afatgjatë, që lidhet me kontributet shoqërore dhe shëndetësore të paguara rregullisht. **Specifikisht, 22.1% e të anketuarve në Maqedoni janë përgjigjur se preferojnë të jenë punëtorë të padeklaruar me një pagë më të lartë, se sa punëtorë të deklaruar me një pagë më të ulët, 22.7% në Shqipëri dhe, mjaft interesante, vetëm 7% në Kosovë.** Kosovarët kanë perceptime pozitive mbi ekonominë formale dhe e shohin atë si më të qëndrueshme në terma afatgjatë, duke pasur parasysh përfitimet që ata do të kenë në aspektin e kontributeve të pensionit.



Grafiku 5 – Niveli i pranimit të deklaratës 'Do të preferoja të isha një punonjës i padeklaruar me një pagë më të lartë sesa i deklaruar me një rrogë më të ulët' (Q MK11 E). Burimi: Vrojtimi i CRPM/IDM/D4D 2016 (popullsia).

Mospajtimi me deklaratën (Do të preferoja të isha një punonjës i padeklaruar me një pagë më të lartë sesa i deklaruar me një rrogë më të ulët) nga ana tjetër është i fortë në të gjitha këto tre vende që variojnë nga 65.3% e të punësuarve në Maqedoni (përmirësim nga 58.6% në vitin 2014), 58.5% e të punësuarve në Shqipëri, dhe 69.1% në Kosovë.

Arsimi, jo çuditërisht, luan një rol të rëndësishëm në formimin e perceptimeve, vendimet e ardhshme dhe mundësitë në dispozicion të punës në kontekstin e tregut të veçantë të punës dhe elementet e saj të kërkesës dhe ofertës. Të dhënat, fuqimisht tregojnë se arsimi luan një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e kontratave me shkrim, gjë e cila është evidente nëse shihen nivelet e ndryshme arsimore. Kjo është një e dhënë indirekte për organet rregullatore, se ku ta përqendrojnë vëmendjen në zbulimin e informalitetit, por edhe në rritjen e masave edukuese të synuara në nivel lokal dhe kombëtar.



Grafiku 6 – Përqindja e popullsisë me kontrata të shkruara për punën e tyre primare sipas shkallës arsimore % (Q3 vs Q.D3). Burimi: Vrojtimi i CRPM/IDM/D4D 2016 (popullsia).

Të dhënat tregojnë dallime të dukshme në lidhje me nivelet arsimore, ku vetëm 56.8% e të punësuarve në Maqedoni, 20.6% në Shqipëri dhe asnjë në Kosovë<sup>19</sup>, me arsimin fillor kanë arritur të kenë një kontratë me shkrim për punën e tyre primare. Situata për punonjësit me arsim të lartë të mëtejshëm thekson rëndësinë e arsimit, pasi 90.5% e të punësuarve me arsim të lartë në Maqedoni, 88.9% në Shqipëri dhe 78.3% në Kosovë kanë një kontratë me shkrim për punën e tyre primare (Shih Figurën 6). Të dhënat tregojnë qartë se, pa ndonjë surprizë, probabiliteti për të punuar me kontratë rritet me nivelin e edukimit, dhe kjo është

<sup>19</sup> Arsyeja për këtë është se në kampionin e anketës nga Kosova vetëm 9% e të anketuarve kanë arsim fillor ose më pak. Dhe prej tyre pothuajse të gjithë janë të papunë, ose thjesht kanë një aktivitet të mesëm pa kontratë pune.

veçanërisht drastike kur punonjësit lëvizin nga arsimi primar, në atë të mesëm.




Duke kombinuar të dhënat nga pyetja e mëparshme me të ardhurat e përgjithshme familjare mund të silltet një faktor shtesë që nxit angazhimin në punë të fshehur dhe / ose evazion fiskal (shih 7). Midis 67% dhe 72% e të punësuarve maqedonas nuk pajtohen me deklaratën (*Do të preferoja të isha një punonjës i padeklaruar me një pagë më të lartë sesa i deklaruar me një rrogë më të ulët*) ndërsa midis 22% dhe 17% prej tyre pajtohen me deklaratën në mënyrë të ngjashme në të gjitha nivelet e të ardhurave të familjes. Kjo tregon një përmirësim të madh nga viti 2014 (sheshimi i kurbave marrëveshje / mosmarrëveshje), veçanërisht në nivelet e të ardhurave të familjes që luhaten nga 0 deri në 325 euro.

Punonjësit e Kosovës duket se po ndjekin perceptime të ngjashme si ata në Maqedoni në vitin 2014, që shkon në favor të argumentit se problemi i punës së padeklaruar është në masë të madhe i lidhur me nivelet e larta të varfërisë dhe është në të vërtetë një mekanizëm përbalues i përdorur nga individët që përpiqen që të mbyllin nevojat e tyre me financat që kanë. Megjithatë, ky lloj mendimi dhe sjellja e tij konsekuente rrit rrezikun, që grupet e pafavorizuara ekonomikisht të jenë edhe më shumë në rrezik, kur vjen nevoja për pagesa sociale.

***Sistemi tatimor progresiv i implementuar pa masa pozitive për të nxitur punonjësit me paga të larta të deklarojnë punën dhe paguajnë taksat e tyre, mendohet të rrisë nxitësit për aktivitete të fshehura ekonomike d.m.th evazion fiskal.***

Të dhënat për Shqipërinë megjithatë tregojnë një histori të ndryshme. Në përgjithësi ajo që konstatohet për Maqedoninë dhe Kosovën është se në rastin e mos rënies dakord me pohimin (*Do të preferoja të isha një punonjës i padeklaruar me një pagë më të lartë sesa i deklaruar me një rrogë më të ulët*) kurba ka tendencë rritëse me rritjen e nivelit të të ardhurave. Në Shqipëri, punonjësit shqiptarë që jetojnë në familje që fitojnë deri në 728 euro,

pajtohen dhe nuk pajtohen me deklaratën, në përqindje relativisht të ngjashme me atë që mund të shihet në Maqedoni dhe Kosovë. **Por, niveli i pranimit, bie nga 65% në 61% për punëmarrësit më të pasur, që kanë të ardhura më të mëdha se 728 euro.** Pra në rastin e Shqipërisë, me rritjen e nivelit të të ardhurave ulet mospranimi me deklarimin e sipërpërmendur.



Grafiku 7 – Maqedonia, Shqipëria, Kosova, (Mos)pranimi me deklaratën ‘Do të preferoja të isha një punonjës i padeklaruar me një pagë më të lartë sesa i deklaruar me një rrogë më të ulët’ dhe të ardhurat mujore (Q. D27B vs. MK11E). Burimi: Vrojtimi i CRPM/IDM/D4D 2016 (popullsia).

Mund të ketë shumë faktorë të ndërthurur, që janë përgjegjës për këtë mospërputhje, por njëri prej tyre mund të jetë i lidhur me faktin se që nga viti 2014 Shqipëria anuloi taksën e sheshtë 10% të tatimit mbi të ardhurat dhe zbatoi tatimin mbi të ardhurat progresive prej 13% për të ardhurat mes 220 dhe 950 euro, si dhe një tatim i të ardhurave prej 23% e të punësuarve me të ardhura më të mëdha se 950 euro<sup>20</sup>. Tatimi progresiv i të ardhurave është një barrë shtesë e taksave, që mund të nxisë punonjësit me të ardhura më të larta, të kenë një qëndrim negativ ndaj formalizimit të bizneseve të cilat nga ana tjetër mund t'i bëjnë ata që të kërkojnë mënyra se si të shmangin e të mos deklarojnë aktivitetin e tyre ose masa të tjera për të shmangur pagimin e taksave, pavarësisht se i kanë mundësitë për ta bërë këtë.

#### 4. Konkluzione

Puna e padeklaruar është një nga shfaqjet kryesore të ekonomisë së fshehur, që ndikon tek njerëzit në kuadër të një shumëllojshmërie të mjediseve social-ekonomike, e cila në të njëjtën kohë është e karakterizuar me rezultate të mundshme negative duke filluar nga tensionet sociale, pabarazitë në rritje dhe boshllëqeve në të ardhura, si dhe të korrupsionit dhe aktiviteteve kriminale. Dy vendet kanë statusin e kandidatit të BE-së, dhe Kosova ka nënshkruar marrëveshjen e stabilizimit dhe asociimit me BE-në, por të tre janë karakterizuar nga norma më të larta të papunësisë, sesa mesatarja e BE-së prej 9.6% (prill 2015), rrjedhimisht, nivelet e larta të punës së padeklaruar, të vlerësuara nga disa studime, janë më shumë se 30% e PBB-së në të tre vendet.

**Shkalla e madhe e papunësisë (24% në Maqedoni, 15.9% në Shqipëri dhe 32.9% në Kosovë, sipas të dhënave të tremujorit të dytë 2016), është një nga treguesit më të rëndësishëm që ndikon në rritjen e aktiviteteve dhe praktikave të ekonomisë së fshehur. Megjithatë, pavarësisht nga gjetjet e fundit të**

efikasitetit më të madh të masave të buta, fokusi kryesor në trajtimin e punës së padeklaruar, ashtu si shumica e vendeve të Evropës Lindore, mbetet ende në një masë të madhe në ndëshkimin e shkeljeve të ligjit të punës. Edhe pse kohët e fundit janë marrë masa që synojnë përmirësimin e zbulimit/targetimit më të mirë, ende masat represive të punësimit janë qasja dominuese e politikës në këto vende. Pagat e fshehura mbeten shqetësimi më akut, me të ardhurat e punësimit që janë pjesërisht ose plotësisht të padeklaruar për gati gjysmën (44%) e të punësuarve në Maqedoni (një rritje prej 40% në vitin 2014), 36% në Shqipëri dhe 37% e të punësuarve në Kosovë.

**Në mënyrë të konsiderueshme, 9% e të gjithë punonjësve të Maqedonisë me punë primare punojnë pa kontratë (në rritje nga 7% në vitin 2014), dhe nuk iu paguhet ndonjë kontribut i sigurimeve shoqërore. Përqindja e këtyre të punësuarve në Shqipëri dhe Kosovë është dy herë më e lartë dhe përfaqëson përkatësisht 17% dhe 21% të të gjithë punonjësve. Për ata që kanë një punë të dytë, të dhënat janë edhe më të zymta. 40% e punonjësve me punë të dytë në Shqipëri dhe mbi 80% në Maqedoni dhe Kosovë punojnë pa kontrata dhe nuk iu paguhet kontributet shoqërore, apo ato të kujdesit shëndetësor.**

Edukimi ka rëndësi në punën e padeklaruar. **Vetëm 56.8% e të punësuarve me arsim fillor në Maqedoni, 20.6% në Shqipëri dhe asnjë në Kosovë, kanë fituar një kontratë me shkrim për punën e tyre primare në krahasim me mbi 80% për punonjësit me arsim të lartë.**

Më shumë se 1/3 (37.3%) e të punësuarve në Maqedoni, ¼ (22.7%) në Shqipëri dhe 1/5 (20.5%) në Kosovë i kanë kontributet e tyre të sigurimeve shoqërore të paguara nga punëdhënësit për pagat e kontraktuara, që janë më të ulëta se paga aktuale që ata marrin. Punësimi dytësor/shtesë rezulton më problematik në drejtim të mungesës së kontratave me shkrim dhe **rreth 90% e këtyre të punësuarve në Maqedoni dhe Kosovë (Shqipëria bën përjashtim**

<sup>20</sup>Invest in Albania website, Short overview of the Albanian tax system. Accessed 05.10.2016 <<http://investin-albania.org/taxation-system/>>

këtu) **nuk kanë kontratë me shkrim** dhe vetëm shumë pak janë të përkushtuar të paguajnë sigurimet e tyre shoqërore, kontributet shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.

Kjo analizë është vetëm maja e ajsbergut e të dhënave që përshkruajnë dinamikën e fshehur të ekonomisë në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë dhe në veçanti punën e padeklaruar. Të gjitha aspektet e punës së padeklaruar në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë, që paraqiten këtu kanë për qëllim të shërbejnë si një udhërrëfyes, për studiuesit dhe politikëbërësit, që punojnë në këtë fushë, për të pozicionuar më mirë politikat aktuale, për të orientuar më mirë mekanizmat, që synojnë të ulin tendencat e ekonomisë së fshehur, si dhe në të njëjtën kohë duke u siguruar që nevojat e shtresës më të brishtë të përmbushen në mënyrë të përshtatshme. Raporti i ardhshëm do të analizojë dinamikat e evazionit fiskal në të tre vendet, si ato përshtaten dhe reagojnë ndaj ndryshimeve të mjedisit politikë bërës dhe kuadrit të incentivave/disincentivave, që krijohen gjatë rrugës së zbatimit të këtyre politikave. Në përfundim, edhe pse ka një tendencë për të etiketuar punëtorët e padeklaruar dhe aktivitetet e tyre ekonomike si "të këqija", duhet të jemi të vetëdijshëm se "... në të vërtetë ky është një reagim i natyrshëm dhe i paprovokuar ndaj pamundësisë së ekonomisë formale për të kënaqur nevojat e një pjese të anëtarëve të saj të shoqërisë."<sup>21</sup>

---

<sup>21</sup>Mema, Fatmir and Zef Preci (2003), "Comments on: Hidden Economy a Barrier for a Sustainable Development", Fourth Conference of Bank of Albania "The Albanian Economy: Progress and C 2003, Saranda, Series of books on scientific conferences, 63-69. P. 63.